




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Ministarstvo
Finansija, Rada i Trasfera –
Ministry of Finance, Labour and Transfers



19.08.2022

FTESË PËR APLIKIM

PËR ANËTAR TË KOMISIONIT VLERËSUES TË THIRRJES PUBLIKE PËR OFRIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR ORGANIZATAT JO-QEVERITARE QË OFROJNË TRAJNIME PËR AFTËSI TË BUTA PËR DERI 300 PUNËKËRKUES (MOSHA 18 – 24 VJEÇ) NË 7 QENDRAT KRYESORE TË KOSOVËS

Bazuar në Rregulloren e Ministrisë së Financave Nr- 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në Nenin 8, paragrafi 3.2 parasheh që pjesë e çdo Komisioni Vlerësues për vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve të pranuar sipas thirrjes publike duhet të jenë dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, duke përfshirë një përfaqësues të OJQ-ve.

Për këtë qëllim MFPT fton të gjithë të interesuarit që të aplikojnë për të qenë pjesë në cilësinë e anëtarit të Komisionit Vlerësues për të vlerësuar projekt aplikimet e dorëzuara nga OJQ-të sipas thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare për OJQ-të që ofrojnë trajnime për aftësi të buta për deri 300 punëkërkues, të datës 08.08.2022 të publikuar nga Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK) / Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT).

Të gjithë kandidatët të cilët nuk janë nën hetime apo me precedent penal dhe që kanë përvojë në shoqërinë civile me përparësi nga OJQ-të që merren me fushën e shërbimeve sociale apo fusha të ngjashme, u mundësohet të aplikojnë për pjesëmarrje në Komisionin Vlerësues në cilësinë:

- Një përfaqësues nga OJQ-të;
- Një përfaqësues në cilësinë e ekspertit.

Të drejtë aplikimi kanë

- Të punësuarit në organizatat jo-qeveritare aktive në Republikën e Kosovës;

- Ekspertë të pavarur, cilët kanë të paktën 5 vite përvojë pune profesionale, preferohet përvoja e punës në administratë publike apo shoqëri civile.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte

- Duhet të kenë të kryer së paku nivelin e studimeve bachelor;
- Të kenë të paktën 5 vite përvojë pune;
- Të kenë përvojë në projektet e OJQ-ve;
- Të mos jenë të emëruar politikë, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente

- Një CV të përditësuar;
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës.

Aplikimi mund të bëhet përmes e-mail: aprk.info@rks-gov.net, dhe në subjekt të e-mailës titulli duhet të jetë “Aplikim për Anëtar të Komisionit Vlerësues” deri me datën **28.08.2022**.

APRK do të vlerësoj të gjitha aplikacionet e pranuar dhe kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara përmes kësaj ftese publike do të jenë pjesë e Komisionit Vlerësues të thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare për OJQ-të që ofrojnë trajnime për aftësi të buta për deri 300 punëkërkues **08.08.2022** të publikuar nga APRK.